

LORETA VASO

MARRAMENDJE
TINGUJSH

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Eris Rusi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-376-55-8

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Marramendja e bukur prej tingujve të shpirtit

Vëllimi poetik “Marramendje tingujsh” i autores Loreta Vaso është në vetvete një lëndë poetike që sillet si traktat shpirtëror i saj, për disa nga raportet universale të njeriut. Një ndër më dominantët në këto raporte është ai i mallit për të munguarit dhe të mërguarit, por jo distantët.

Tek “të munguarit” janë njerëzit e amëshimtë dhe të dashurit jetëndërruar, të cilët, në marrëdhënien e brendshme komunikuese me autoren, kanë uzurpuar një tërësi si kohore dhe shpirtërore tek autorja.

Në dhjetëra prej poezive të këtij libri, shëtit në leximin tekstual, si në një botë boreale, ku shfaqen “fluturat e shpirtit”, por edhe gjurmët e dhembshurisë dhe të adhurimit për të munguarit.

Disa prej poezive janë asosacion i një pëshpërime vijuese, rrjedhëse dhe shumëngjyrëshe që të shtyn në një marramendje njeridashëse. Kjo vjen prej autores bijë dhe nënë, prej një zonje dhe zonjëze zemërndjeshme.

Raporti tjetër dallues, në tekstet e këtij vëllimi, është ai që çmon dhe ndien autorja me të dashurit e mërguar dhe ata të distancave gjeografike në jetën aktuale të saj.

Këtë raport autorja e sjell klasikisht në formën e vet përjetuese si dhe natyrshëm përmes vargjeve të lira.

E mishëron ndjesinë vetjake dhe gjendjen në të cilën udhëton përditshmërisht, tek teksti i thjeshtë, por sintetik. Priret drejt vargut që nuk e potencon figuracionin, por e vesh atë natyrshëm në kuptimësinë e tij.

Në secilën prej strofave të poezive reflekton mërmërimat dhe drithërimat shpirtërore, plot mall, dhimbje, përkujtesë, përmallim dhe adhurim prej një zonje me fjalë dhe shpirt delikat, por edhe rezistent.

Në këtë mërmëritje poetike ajo të shtyn në shijimin e ndjesishëm të asaj që pohon Niçja: “Unë s’shoh ndonjë ndryshim midis lotëve dhe muzikës”. Sepse në këto poezi, autorja e shuan këtë kufi, duke e konvertuar qashtërsinë e mallit për atin e vet biologjik, nënën apo për motrën e mërguar, në një muzikë malli pohues, në një “drithërimë” prej shpirti gruaje: Shpirti i gruas - drithërimë/ Kujtimeve u kthehem me mallin në sy,/ kohës që rend i pëlqej çdo ngjyrë./ Ka follenë ai shpirt, - drithërimë!”.

Duke e mbajtur në fuqi (në tërësinë e librit) këtë marrëdhënie, autorja nuk i nënshtrohet, por e sendërton dhe e mbart fisnikërisht atë, si një “marramendje” shpirtërore, prej së cilës “kur humbas,/ në të tijën kthjelltësi”.

Poezia e Loreta Vasos ka adresime dhe vjen si reflektim marrëdhëniesh e lidhjesh ndërshpirtërore. Në këtë aspekt ajo mbart veçanësinë e autores si zonjë që tenton dhe priret drejt rrafshëve të komunikimeve shpirtërore. Sjell poezitë e veta (pa e fshehur, por

madje duke e deklamuar), ndërgjegjen tradicionale të adhurimit dhe respektimit të familjes klasike.

Poezia “Një ditë para ikjes së saj” (Largimi i motrës), është ilustrimi më sintetik i kësaj lidhjeje dhe dëshirimi divin për të afërtën e gjakut të vet. (Pamë në sy njëra-tjetrën,/ ajo me të kuqin fustan,/ Me sharmin e jetës pranë/ dhe mallin e prindërve tanë.)

Libri “Marramendje tingujsh” ka një materie fjale, e cila mishëron edhe një raport tjetër të autores. Është fjala për raportin me visin, me toposin dhe hapësirën shpirtërore që zbulohet prej tij. Këtë hapësirë, poetja nuk e poetizon, por e sjell tekstualisht si imazh dhe hise peizazhi dhe dukurish, ashtu sikundër është, imponues dhe ftues në realitet.

Një cikël i plotë poezish për detin, zbulojnë gjatë leximit imazhet e njohura të bregdetit shqiptar në jug të vendit, atje ku kaltërsia dhe dimensionin i ujtë, shtyjnë inspirime dhe reflektime poetike për çdokënd e më së shumti për poetin - bijë të detit.

Në këtë marrëdhënie autorja nuk është thjesht romantike, por personazh që vetërrëfen thelbin dhe thellësitë e marrëdhënies. Ka një tekst metonimizues: Deti... / Stepem për pak, nuk marr as frymë,/ Vështrimi në sy, ngjyroset prej tij,/ Më kot kërkoj nëpër kaltërsi/ sirenat lozonjare që s’prekin mëri.

Regjistri i ndjeshmërisë poetike të Loreta Vasos dhe sidomos i “marramendjes” prej marrëdhënies me toposin e saj, përbën aspektin e parë karakterizues në këtë vëllim.

Ajo ndien dhe ndjek, regjistron dhe shijon, tingujt e gjumit, të detit dhe të pemës, të stinës dhe të shpirtit, të botës dhe brendabotës.

Mes botës së preکشme dhe asaj eterne, poetja zhbën krejt kufijtë dhe të sjell si më të preکشme ndjesitë e hapësirës shpirtërore. (E pamë në një ëndërr/ Në një ëndërr vallë, kishim qenë bashkë,/ mikja e saj e mirë, unë dhe malli pranë?)

Nuk është autore e shëtitjeve romantike në territore ëndërrimesh apo imagjinare, por është një bijë dhe zonjë ndalimesh për arsye nderimi e malli, për motive të fisme gjenealogjie dhe identiteti shpirtëror. Në emër të këtij obligimi të fismë, ajo vjershëron duke mishëruar kadencën e brendshme. (Më kot/ ...Tingujt e fjalëve dëgjoja së largu, ato dhe heshtjen e përcillnin me hir./ Zhurmonin të tjerat, rënkonte shpirti,/ naziket, të urtat, kërkoja, por fir...)

Mërgimi dhe arratitë njerëzore, për poeten, janë proceset e dhimbshme të rrudhjes së shpirtit. Kësi rrudhjesh deformatojnë edhe vetë natyrën, ose si thotë autorja: “Kur arratiset mendimi/ Zhurmat endacake,/ jo vetëm mendimin,/ por edhe dallgët i kanë rrudhur.”.

Në shumë prej poezive të këtij libri, ku përmes fjalës autorja sjell fotografi peizazhesh me det dhe detaje e elemente imagjinative parajse, na riprovon atë që aq bukurisht e shpreh Emil Cioran: “Vetëm parajsa, apo deti mund të ma heqin mendjen nga muzika” e jetës prej njeriu.

Aleksandër Çipa

Marramendje

Jam në marramendje,
kur humbas,
në të tijën kthjelltësi.
Zanafilla më kërkon,
dhe qëmtoj gurët,
sa më step cektësia,
aq më tremb turbullira,
që të shpie s'di se ku...

Në mistiken dhunti,
metaforat do t'i zbuloja,
thellësive të kthjellëta,
mbi format e valëve
do ta hidhja vargun,
që fjalët të ngjyheshin
në të kaltrën e tij,
dhe ritmi t'i përngjante
atij dallgëzimi.

Dhimbja e vetmisë

Vetmia më ngjan me lotët,
që nga dhimbja lindin dhe bien,
veç, jo si ata të gëzimit,
që qeshin kur shpërthejnë.

Vetmia, ka brendinë e dikujt,
qoftë grua apo burrë,
që thërret: jam vetëm,
në këtë botë me zhurmë!

E kam parë të tillë ngjyrë,
të zbehtë e trishtë mbi fytyrë,
pagën e moshës duke marrë,
vetmevete, e heshtur, pa fjalë.

Dhe te një fëmijë parë e kam,
kur kërkon të luajë a të qajë,
në pakohësinë e ditënatës,
që prindi nuk mund ta ndajë.

Madhohet, pushton, përpëlitet,
pa dukur, strukur në lëkurë,
zverdh ngjyrën dhe besimin,
ajo, që dritë të jepte dikur.

Nga vetmia vrastare, larg
të ikësh, të rendësh sa mund.
Çdo gjurmë përndjekëse e saj,
të fashitet kërkon me ngulm.

Shpirti i gruas - drithërimë

Kujtimeve u kthehem me mallin në sy,
kohës që rend i pëlqej çdo ngjyrë.

Fëmijëve kudo, u përulem me përdëllim,
Se pas nuk po u lëmë një botë më të mirë.

Diellit i lutem për pak ngrohtësi,
se deje e damarë cikna i ka ngrirë.

Hënës së zhveshur i falem me dëshirë,
shpirti të çlodhet në të sajën gjysmëdritë,

Përqafimit i kërkoj të më sjellë tek ti,
që intimitetin ta njoh nga aroma e mirë.

Në çdo tingull dhe zë që përcjell melodinë,
në çdo fjalë e mendim, që mban gjallë dashurinë.

Ka folenë ai shpirt,
- drithërimë!

Djali me kitarë

Ditës i thirri, mos e kish parë,
trokiti, trokiti në pragun e saj.

Dita e dehur nga ritmi i vet,
i ngriti supet, ra dhe u mek.

Dhe mbrëmja kur erdhi, s'i tha asnjë fjalë,
në shpirt kishte zjarr, në dorë një kitarë.

U drodhën telat, sa hëna rënkoi,
tingujt si perla, asaj ia dërgoi.

U zgjuan kujtimet, mbi tela qëndruan,
mos vallë vegimet, kitarën ngacmuan?

Por tingujt u tretën, si vesa mbi bar,
kur fryma e saj u preh mbi kitarë.

Fëmijëria

Të tyret thirrjet e mëndafshta
kapeshin nëpër kangjella,
zbrisnin mbi të bardhat pllaka,
zhyteshin në dallgët e larta.

Ejani shpejt, ngjituni lart,
jemi këtu, vijnë për pak,
të vegjlit në ngjyrë të zeshkët,
të lagur si flad i freskët.

Me shijen e kripës së detit
dhe erën e jodit mbi krye,
ata mësonin të rendnin,
pse jo, të kapnin yjet.

Dhe doja unë parajsën,
ta ripërshkoja sërish,
që detin nga ballkoni,
ta kisha shtëpi, brenda sysh.

U enda ndër rrugica,
nëpër ca shtigje humba,
me mure e ndërtesa
të ngjeshura si fortesa.

Na ish njëherë një kohë,
lakmia nuk bërtiste,
kur deti, vogëlushët,
në krahë i nanuriste.

Na ishte fëmijëria, seç na ishte...

Aroma e butë

Më pëlqen ajo aromë,
as e rëndë, as e fortë,
delikate dhe e butë,
si pranvera kur afron.

Ajo struket në lëkurë,
nuk thërret, nuk kundërmon,
të rri pranë me finesë,
ndjeshmërinë të kujton.

Nuk e ndaj, ngado që shkoj,
më qetëson, më përkëdhel.
Vrazhdësinë nëse takon,
e shpërfill, sensualja erë...

Një ditë para ikjes së saj
(Largimi i motrës)

Pamë në sy njëra-tjetrën,
ajo me të kuqin fustan,
me sharmin e jetës pranë
dhe mallin e prindërve tanë.

Nuk mund ta ndal kohën, jo.
Vetë ikja, kryeneçe dhe e sertë,
sa shumë njerëz merr me vete,
portë-pritjen lë, tek të tjerë.

Sytë i ngul në një ekran,
ndihem stinë kur të kam pranë.
Varur mbi xham mbetet malli im.
Por i pafund, oqeani që na ndan!

Sa shumë më mungon

Kërkoja një lule, e doja erëmirë,
ta mbillja me rrënjë, jo t'i prisja dritën.
U enda, sa shumë ndër kopshte, ograja,
askund s'e gjeta të butën, të brishtën.

Më mbetën sytë te një kopsht i bukur,
u zgjata, ta kapja me sy erëmirën,
që qeshte mes lulesh, e lehtë si flutur,
shpenguar më iku, më ndezi dëshirën.

Kopshtari i thinjur me sharmin mbi supe,
butësisht i prekte, po fliste me lulet.
Nga larg e kundroja tek i nanuriste,
timen erëmirë, marrë e kish me vete.

Ah, si nuk mundja, ta shtyja unë portën,
të lartë e të rëndë sa t'i merrja rrënjën,
shtegun po zhbiroja, sa të fusja dorën
dhe nëse e prekja, t'i ndieja aromën!

Deti...

Me valët e detit filloj të flas,
puhiza e lehtë më vjen si fllad,
pëshpërimat e tij më sjell ngadalë,
e dehur unë jam nga ky magjistar.

Gjuhën e tij lus për ta ditur,
me tinguj të butë, të larë me shkumë.
Brenda vetes ia njoh shumëçka,
por shumë të tjera s'i kuptoj unë.

Stepem për pak, nuk marr as frymë,
vështrimi në sy, ngjyroset prej tij,
më kot kërkuj nëpër kaltërsi
sirenat lozonjare që s'prekin mëri.

Pranverë e vonuar

Sa shumë po vonon,
as ngjyrat nuk po duken,
diku kanë ngrirë e presin,
diellin t'u ndrijë supeve.

E presim me dritë në sy,
se shpirtit i jep zjarr,
dikujt i zbut një plagë
një tjetër deh me flad.

Dhe ngrica mbetur pas,
nga dimri i gjatë në prag,
po ndien ardhjen e saj,
tek zbutet pak nga pak.

Ajo vërtet ka ardhur,
pa naze përmbi vete,
një pelerinë të lehtë,
mbi supe e ka hedhur.

E duam dhe pa ojna,
të lagësht dhe të purpurt,
me jetën krah për krah,
natyrën zgjon nga gjumi.

E pamë në një ëndërr

Në një ëndërr, vallë, kishim qenë bashkë,
mikja e saj e mirë, unë dhe malli pranë?

S'qenka e sëmurë, thirra plot me gaz,
lotët tanë u prehën, mbi gërshetë të gjatë.

Ishte mugëtirë, mjegullnajë e bardhë,
më kish lënë pa fjalë bukuri e saj!

U bëra e vogël, vetveten harrova,
dhe nëpër kujtime, time më kërkova.

Gjumin ma trazoi, mikja e saj e mirë,
zgjuar a në gjumë, ndihesha e mpirë.

Ëndrra jonë e bardhë e preku ndjesinë,
malli udhëton, bashkë me dashurinë.

Edhe kur nuk shkoj vërtet

Jam në vendin e bekuar,
bashkë me mallin që rri zgjuar.
E ndiej oshtimën e maleve,
si tretet në shkumën e valëve.

Vështrimi im arratiset,
zhytet, kridhet poshtë në det.
Sundon e kulluar qetësia,
as kuvendi i zogjve nuk e prek.

Dhe mister, dhe mrekulli,
është kjo pllajë në lartësi.
Si një plak që tespohet numëron,
ngjason lisi shekullor, përkarshi.

Edhe kur nuk shkoj vërtet,
kur me mendje fluturoj,
më kërkon një amanet,
bashkë me të, zë e udhëtoj.

Amaneti që merr krahë,
dhe në tokë dhe mbi re,
baballarët i mban gjallë,
gjelbërimi rron veç me ne!

Më kot

Tingujt e fjalëve dëgjoja së largu,
ato dhe heshtjen e përcillnin me hir.
Zhurmonin të tjerat, rënkonte shpirti,
naziket, të urtat, kërkoja, por fir.

Si mund ta hedhësh ankesën në vargje,
kur fjalët këmbëzbathur ndër pragje çapiten.
Më dhimbset fjala që rënkon sa herë,
lëndesat që shtohen, përbrenda përshpirten.

E para është fjala, e lashtë sa koha,
Në libra me mendje dhe art qëndisur.
Mes tyre njeriut iu shtua boja,
udhëtar në vise, për dije degdisur.

Me gjuhën e flakës

Gjuhët e flakës luhaten,
teksa qiriri digjet ngadalë,
ato anohen, diku tulaten,
sikur po shkruajnë ca fjalë.

Është çasti i brishtë i ndarjes,
i largimit të njeriut nga jeta,
flaka e qiririt dridhet si heshtja,
që davarit pëshpërimat e lehta.

Format e saj i përqas me fjalët,
zgjatimet e mprehta si dhimbja,
dridhjet e shpeshta dot s'i mat,
si nuk mund të matet humbja.

Qirinjtë pak nga pak u tretën,
të mekur mbetën sytë e përlotur.
Providencë, ku hyri ai shpirt?!
Ç' dritë vallë e ka rrokur?!

Aromë dashurie

Teksa fikej pak nga pak,
porsi bimë e zhuritur,
ende mban gazin në buzë,
fjalën veç, të përpëlitur.

Jeta merr pamjen e tij,
dhe pse mbahet si mezi.
E tendosur porsi fill,
rrjedhë që s'e shihte sy.

Përqafimi që e mban,
ka aromë dashurie,
dhe çdo puthje si balsam,
shtonte lutje mrekullie.

Mërgimtari

Mendimin e ikjes s'mund ta mbajë shpirti,
kur mërgohem, pas më ndjek i tiji mall.
Sa i bukur është ky vend, vend i rrallë,
si një burrë sqimatar, që ngrohtë të mban.

Sa e trishtë vjen kjo fjalë: mërgimtar,
por të shkoj është më mirë se të ndal!
Bëj të rri, prehem paksa, fare pak,
se natyra më tundon, mbetem pa fjalë!

Dhe qëndrova,
sa lëndimi u lëndua gjer në skaj,
aq sa lotët,
u ngurosën krejt pa faj.

Edhe shkova, bashkë me shpresën,
se prehja pas brengës së gjatë,
do të frymonte paskëtaj.

Nuk u ndodha në anijen e Haroldit, djalë,
por brenga ime me të Bajronit varg,
në kohë të pastajme u takuan, larg.

Njerëz dhe vështrime

Më përndjek një vështrim,
ndoshta e ke ndier dhe ti,
është i ftohtë si thëllim,
vjen i zbrazët si qeli.

Një vështrim të përndjek,
kur të flet, i ftohtë krejt,
e thërrmon edhe ditën,
e gjurmon edhe ëndrrën.

Rrugën humb si endacak,
ai endet në askund,
ndodh që erret, errësohet,
dhe nga drita egërsohet.

Të përshkon tejpertej,
por as sytë nuk t'i hedh,
kur dhe shpirti tjetërsohet,
copë-copëza ai thërrmohet.

Një vështrim me dritë në sy,
ngazëllehet si fëmijë,
bëhet këngë a melodi,
përqafim a shkëndijë.

Një vështrim dritëkulluar,
jetën puth i dashuruar,
bashkë me hënën fle zbuluar,
të zgjojë ditët pa aguar.

Veç vështrimi i munguar!

Pritja

Sonte prita gjatë,
qe një muzg i vonë,
hëna si e vrarë,
më qëndronte pranë.

Qëndrova aq gjatë,
sa e humba kohën,
ishte muzg i paqtë,
por natë e acartë.

Nuk e mata kohën,
me asnjë njësi,
mbledhur në një natë,
sa kish hedhur shtat!

Pritja mbeti varur,
si mjegull në terr,
u shkund e përgjumur,
sa veten nuk merr.

Më pas kryet uli,
si fiket vështrimi,
shpresën e pështolli,
kur zgjohej agimi.

Si dashuria e tyre

Aq e bukur, porsì dielli kur zë çlodhet,
merr të kuqen në të purpurt dhe largohet.

Dhemb aq shumë, sa lotojnë edhe gurët,
kur zëdredhur, e vërteta përshkon udhët.

Dashuria herë e zjarrtë, herë si brymë,
shpirti i tij udhëton me të sajën frymë.

Det i kaltër, thellësive më dërgon,
nëpër dallgë rrekem ta gjej, atë pasion.

Je i humbur nëse librin larg e mban,
se Remark a Balzak të lënë pa fjalë.

Nëpër fjalë e rrëfime fluturonim,
dashurinë si në libra ëndërronim.

Por e gjeta sa të brishtë, aq të marrë,
dashurinë krejt të pastër, si kristal.

Tokësore dhe hyjnore bërë bashkë,
është e tyrja dhe në zë, dhe në fjalë.

Që të shkruaj për të tyren dashuri,
kur uria kafshon fjalët me lakmi,

që të mund të tyren dashuri ta ndaj,
ngjyey fjalët dhe në lot, dhe në zjarr.

U magjepsa (Për Marizën)

Zëri i saj kumboi, më shtegtoi shpirti,
gjendur në lëndinë, melodinë e ndiqni.

Veten shpejt e gjeta, bërë isha fëmijë,
frymë as po merrja, kruspull pranë tij.

Nuk doja t'i ikja, mallit për tim atë,
por zëri i saj, më rrëmbeu prapë.

Herë të nanuriste, nëpër valë e dallgë,
herë të magjepste si ndodh në përrallë.

Tingujt e kitarës binin në të qarë,
lot mërgimtarësh nëpër botë shpërndarë.

Hëna hodhi dritën, mbi tingujt e rrallë,
zërat me të saj, ishin shkrirë bashkë.

Befas u thërrmuan, tingujt edhe fjalë,
ishte vetë Fado, në zërin e saj.

Kur ajo i grishte me fadon kitarë,
njerëzit pas e ndiqnin në të saj, zjarr.